



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 90

Tiranë – E martë, 28 prill 2026

PËRMBAJTJA

		Faqe
Udhëzim i ministrit të Mjedisit nr. 1, datë 22.4.2026	Për mënyrat e shënimit të kufijve të zonës së gjuetisë.....	8275
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe i ministrit të Financave nr. 3, datë 26.3.2026	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 19, datë 22.11.2022, “Për tarifat e të ardhurave dytësore të aplikueshme nga institucionet vartëse të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”, i ndryshuar...	8277
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 6, datë 10.4.2026	Për përcaktimin e procedurës së monitorimit të zbatimit të kontratave për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit në ujërat e brendshme dhe të akuakulturës në sipërfaqe tokësore dhe ujore.....	8278
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 402, datë 15.4.2026	Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 275, datë 5.5.2023, “Për miratimin e lëndëve vepruese dhe përbërësve të tjerë, në përmbajtje të PMB-ve”, të ndryshuar.....	8280
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 407, datë 17.4.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajes afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Spanjës.....	8288
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 423, datë 20.4.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajes afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Italisë.....	8290
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 424, datë 20.4.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë....	8293
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 428, datë 21.4.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	8294

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 429, datë 21.4.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë.....	8296
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 430, datë 21.4.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë	8297
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 431, datë 21.4.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	8298
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 432, datë 21.4.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Mbretërisë së Bashkuar.....	8300
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 433, datë 21.4.2026	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 292, datë 17.3.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Francës”.....	8301
	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK).....	8301
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 266/10, datë 21.4.2026	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Projekti arkitektonik i rrugëve ‘Myslym Gjoleka’, ‘Ahmet Lepenica’, ‘Hysni Muka’, në lagjen ‘Kushtrimi’, Bashkia Vlorë’”.....	8301
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan nr. 308, datë 4.3.2026	Për shpalljen të vdekur të shtetases Eda Hasani.....	8305

**UDHËZIM****Nr. 1, datë 22.4.2026****PËR MËNYRAT E SHËNIMIT TË KUFIJVE TË ZONËS SË GJUETISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 10, të ligjit nr. 89/2025, “Për Gjuetinë”,

UDHËZOJ:

1. Identifikimi, zonimi dhe shënimi në terren i kufijve të zonave të gjuetisë kryhet në përputhje me përcaktimet dhe kriteret e kreut III, të ligjit nr. 89/2025, “Për gjuetinë”, me qëllim përgatitjen e dokumentacionit për propozimin e miratimit të zonës së gjuetisë.

2. Kryetari i bashkisë ngre me urdhër një grup pune, të përbërë nga specialistë të strukturave përgjegjëse për natyrën dhe biodiversitetin pranë njësi të vetëqeverisjes vendore, të asistuar nga një jurist, si dhe me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të shoqatave dhe federatave që operojnë në fushën e gjuetisë.

3. Shënimi në terren i kufijve të zonave të gjuetisë kryhet duke u mbështetur në kriteret e përcaktuara në ligjin për gjuetinë, të cilat konkretizohen në elementet, si më poshtë:

a) Kriteret ekologjike:

i. prania e llojeve të faunës së egër objekt gjuetie në densitet të mjaftueshëm për shfrytëzim të qëndrueshëm;

ii. ekzistenca e habitateve të përshtatshme për ushqim, strehim dhe riprodhim;

iii. ruajtja e gjendjes së favorshme të ruajtjes së popullatave të llojeve objekt gjuetie;

iv. garantimi i ruajtjes ose arritja e gjendjes së favorshme të ruajtjes së llojeve, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian;

v. shmangia e ndikimeve negative mbi llojet e mbrojtura dhe habitatet me rëndësi të veçantë.

b) Kriteret territoriale:

i. përjashtimi i territoreve të shpallura si zona të mbrojtura, në përputhje me legjislacionin në fuqi për zonat e mbrojtura;

ii. garantimi i një sipërfaqeje minimale dhe me vazhdimësi territoriale, sipas përcaktimeve të ligjit;

iii. mbështetja e kufijve në elemente natyrore ose administrative të identifikueshëm, si lumenj, kreshta, rrugë ose kufij administrativë;

iv. shmangia e fragmentimit të habitateve dhe sigurimi i funksionalitetit ekologjik të zonës;

c) Kriteret e sigurisë publike:

i. respektimi i distancave minimale nga vendbanimet, rrugët, infrastrukturat publike dhe zonat turistike;

ii. parandalimi i rrezikut për jetën dhe shëndetin e njerëzve;

iii. sigurimi i aksesit të kontrolluar nëpërmjet shënimit të qartë të kufijve të zonës.

ç) Kriteret e përdorimit të tokës:

i. përputhshmëria me planet e përdorimit të territorit dhe dokumentet e planifikimit vendor;

ii. shmangia e mbivendosjes me zona të destinuara për zhvillime strategjike, infrastrukturale ose prioritare ekonomike;

iii. marrja në konsideratë e aktiviteteve ekzistuese ekonomike përfshirë bujqësinë, turizmin dhe kullotat.

d) Kriteret e menaxhimit dhe monitorimit:

i. mundësia për monitorimin e vazhdueshëm të faunës së egër dhe të aktivitetit të gjuetisë;

ii. ekzistenca e kapaciteteve institucionale për administrimin e zonës;

iii. mundësia për zbatimin e planit të menaxhimit dhe kontrollit në terren.

dh) Kriteret e qëndrueshmërisë:

i. ushtrimi i gjuetisë pa cenuar ekuilibrin ekologjik;

ii. kontributi i zonës në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në nivel lokal;

iii. integrimi i aktivitetit të gjuetisë me forma të tjera të përdorimit të qëndrueshëm të natyrës, përfshirë turizmin natyror.

4. Në çdo rast, shënimi i kufijve të zonave të gjuetisë bazohet në të dhënat e inventarizimit të faunës së egër, analizat shkencore dhe vlerësimin e ndikimit në biodiversitet dhe nuk mund të shënohen në sipërfaqe territori ku cenohen objektivat e ruajtjes së biodiversitetit dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së natyrës.

5. Në rastet kur zona e gjuetisë shtrihet në territorin e më shumë se një njësie të vetëqeverisjes vendore, pavarësisht pronësisë shtetërore, private, ose të kombinuar, shënimi i kufijve realizohet në bashkëpunim ndërmjet njësi të përkatesë.

6. Nëse zona e gjuetisë ndodhet në kufi me zonat e mbrojtura, shënimi i kufijve kryhet në bashkëpunim dhe koordinim me specialistët e



ADZM-ve vendore, duke pasur parasysh kriteret e përcaktuara në shkronjën “e” të nenit 9, të ligjit nr. 89/2025 “Për gjuetinë”.

7. Kufijtë e zonës së gjuetisë përcaktohen me koordinata gjeografike të matura në terren me pajisje GPS me saktësi minimale ± 3 metra.

8. Për matje përdoren pajisje GPS profesionale, që ofrojnë koordinata në sistemin Koordinatat e Rrjetit Gjeodezik Shqiptar (KRGJSH).

9. Pikat e kufirit regjistrohen në një rrjet gjeodezik të unifikuar sipas sistemit KRGJSH dhe përfshin koordinatat X, Y, si dhe koordinatën Z kur përdoret lartësia.

10. Kur vendosja e shenjave në pikën ekzakte të kufirit nuk është e mundur, për shkak të kushteve të terrenit, shenja vendoset në distancën minimale të mundshme dhe shënohet devijimi në dokumentacionin përkatës.

11. Bazuar në koordinatat e pikave të kufirit, hartohet skica e plan-vendosjes dhe harta gjeohapësinore digjitale e zonës së gjuetisë, e cila është pjesë e dokumentacionit shoqërues të propozimit drejtuar ministrisë përgjegjëse për gjuetinë.

12. Pas miratimit të zonës së gjuetisë me vendim të Këshillit të Ministrave, grupi i punës kryen shënimin në terren të poligonit të sipërfaqes së zonës së gjuetisë.

13. Markimi i kufijve të zonës së gjuetisë kryhet në format e mëposhtme:

a) Vendosja e tabelave treguese në pikat hyrëse, ndarëse dhe në çdo ndryshim drejtimi të kufirit, me këto specifika teknike:

i. tabela metalike ose plastike, të qëndrueshme dhe rezistente ndaj kushteve atmosferike;

ii. madhësia minimale: 100×50 cm;

iii. me ngjyrë të verdhë ose portokalli, të dallueshme lehtësisht në terren;

iv. teksti standard: “ZONË GJUEITIE”, shoqëruar me emërtimin gjeografik dhe simbol përkatës;

b) Vendosja e shenjave vertikale në terren, shtylla metalike, plastike, ose prej druri, në pika të dukshme përgjatë linjës së kufirit të zonës, me lartësi minimale 1.5 m, me ngjyrë të verdhë ose portokalli dhe me kod identifikimi të zonës.

c) Shënimi me bojë në pemë ose shkëmb 10–20 cm. Kjo formë markimi përdoret vetëm në zona pyjore ose shkëmbore, duke u përdorur vetëm bojë ekologjike të padëmshme për mjedisin.

ç) Shënime të tjera duke përdorur gurë shënjes në terren, vetëm në rastet kur, për shkak të kushteve teknike ose mjedisore, nuk mund të përdoren forma të tjera markimi.

14. Të gjitha format e markimit duhet të jenë të dukshme, të qëndrueshme dhe të vendosen në mënyrë të atillë që nuk cenojnë mjedisin dhe nuk dëmtojnë pronën publike apo private.

15. Shenjat e markimit nuk vendosen në elemente të trashëgimisë kulturore ose monumente natyre pa autorizim paraprak nga institucionet përkatëse, përgjegjëse për administrimin e tyre.

16. Shenjat vendosen në këto distanca:

a) deri në 150 m në terren të hapur;

b) deri në 70 m në zona pyjore;

c) deri në 50 m në zona me mbulim të dendur vegetativ.

17. Tabelat treguese sipas shkronjës “a” të pikës 13 të këtij udhëzimi vendosen në pikat hyrëse dhe në çdo kryqëzim, kthesë apo çdo pikë tjetër ku kufiri ndryshon drejtim.

18. Njësia e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse për vendosjen dhe inspektimin periodik të shenjave të markimit dhe tabelave në territorin e saj administrativ.

19. Tabelat dhe shenjat e markimit mirëmbahen nga menaxhuesi i zonës së gjuetisë, në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi.

20. Shenjat e dëmtuara ose të zhdukura zëvendësohen nga menaxhuesi i zonës së gjuetisë brenda 30 ditëve.

21. Për kufijtë e rezervateve të mbarështimit dhe ripopullimit ndiqet e njëjta procedurë sipas parashikimeve të këtij udhëzimi dhe në referencë të nenit 15 dhe nenit 20, të ligjit 89/2025.

22. Ngarkohen njësitet e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MJEDISIT
Sofjan Jaupaj



UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 3, datë 26.3.2026

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR. 19, DATË 22.11.2022,
“PËR TARIFAT E TË ARDHURAVE
DYTËSORE TË APLIKUESHME NGA
INSTITUCIONET VARTËSE TË
MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar; të neneve 7, 44, 125, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të neneve 16, 18, 21, 24, 28, 33 dhe 37, të ligjit nr. 10416, datë 7.4.2011, “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, të ndryshuar; të nenit 14, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar; të neneve 14 dhe 32, të ligjit nr. 8/2019, “Për skemat e cilësisë së produkteve ushqimore dhe bujqësore”; të ligjit nr. 87, datë 14.2.2013, “Për kategorizimin e prodhimit, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit dhe vajit të bërsive të ullirit”; të ligjit nr. 8691, datë 16.11.2000, “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”; të nenit 11, të ligjit nr. 17/2020, “Për produktet plehëruese”; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; të ligjit nr. 86/2022, datë 22.12.2022, “Për vreshtarinë dhe verën”; të pikës 10, të VKM-së nr. 335, datë 6.6.2018, “Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kritereve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar; të pikës 9, të VKM-së nr. 223, datë 13.4.2001, “Për vlerësimin cilësor të markave të cigareve të pranishme në tregun shqiptar”; të VKM-së nr. 515, datë 19.7.2006, “Për ristrukturimin e instituteve kërkimore shkencore në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”; dhe të VKM-së nr. 432, datë 28.6.2006, “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”; si dhe të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit në Programin e Auditimit nr. 123/3 prot., datë 20.1.2025, ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministri i Financave

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr. 19, datë 22.11.2022, “Për tarifat e të ardhurave dytësore të aplikueshme nga institucionet vartëse të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”, i ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Pika 2, ndryshohet si më poshtë:

“2. Tarifat e përcaktuara në këtë udhëzim, nuk aplikohen për testimin e varieteteve nga Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve, për regjistrim në Katalogun Kombëtar, përfshirë regjistrimin me testim dhe regjistrim me DUS nga UPOV dhe CPVO, sipas pikave 73 dhe 74, të tabelës “Tarifat për testimin e varietetit për regjistrim në Katalogun Kombëtar”, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Në kreun III, në tabelën me titull “Tarifat e analizave fiziko-kimike të disa produkteve ushqimore”, pas pikës 15.3 shtohet pika 15.4, me këtë përmbajtje:

15.4	Uji i ambalazhuar	Vlera në lekë
15.4.1	Mbetja e thatë në 180°C	720
15.4.2	pH	320
15.4.3	Fortësia e përgjithshme	800
15.4.4	Kalcium	600
15.4.5	Magnezi	600
15.4.6	Bikarbonatet	600
15.4.7	Kloruret	700
15.4.8	Gazi karbonik me titrim	650
15.4.9	Gazi karbonik me aparat	200

3. Në kreun II, në tabelën me titull “Tarifat e shërbimeve që kryhen nga Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve (ESHFF)”, pika 4 e tabelës “Tarifat për certifikim zyrtar për etiketat, etiketimin dhe rietiketimin zyrtar të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor”, ndryshohet si më poshtë:

“Certifikimi dhe lëshimi i etiketave zyrtare për farërat e bimëve të arave, foragjereve, patates, të prodhuara në vend, për çdo 1–100 kg (të certifikuar): 500 lekë.”

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

MINISTËR I FINANCEVE
Petrit Malaj



UDHËZIM

Nr. 6, datë 10.4.2026

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS
SË MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË
KONTRATAVE PËR USHTRIMIN E
AKTIVITETIT TË PESHKIMIT NË
UJËRAT E BRENDSHME DHE TË
AKUAKULTURËS NË SIPËRFAQE
TOKËSORE DHE UJORE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, pikës 16/1, të vendimit nr. 712, datë 31.1.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit publik për të drejtën e peshkimit në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Ky udhëzim përcakton rregullat dhe procedurën për monitorimin e kontratave për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit në ujërat e brendshme dhe të akuakulturës në sipërfaqe tokësore dhe ujore, me qëllim përmirësimin e mekanizmave të monitorimit përmes një procesi të unifikuar dhe të dokumentuar, duke garantuar trajtim të barabartë të të gjitha kontratave objekt monitorimi.

2. Monitorimi i kontratave synon:

a) Sigurimin e zbatimit të detyrimeve kontraktore dhe ligjore nga subjektet fizikë ose juridikë (*në vijim “subjekte”*), që kanë lidhur kontratë me ministrinë përgjegjëse për aktivitetin e peshkimit dhe akuakulturës (*në vijim “ministra”*) për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës;

b) Identifikimin, dokumentimin dhe vlerësimin e rasteve të mosrespektimit të detyrimeve kontraktore dhe ligjore;

c) Marrjen e masave administrative, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjorë në fushën e peshkimit dhe akuakulturës, si dhe me detyrimet ligjore që burojnë nga kontrata, ndaj subjekteve kontraktore që konstatohet se kanë shkelur kushtet kontraktore ose ligjore.

3. Monitorimi i kontratave kryhet nga struktura përgjegjëse për monitorimin e kontratave të peshkimit dhe akuakulturës në ministri (*në vijim “struktura përgjegjëse”*), në bashkëpunim me

institucionin përgjegjës për inspektimin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës, i cili për kryerjen e monitorimit të çdo kontrate vendos në dispozicion një inspektor, si dhe të dhënat dhe procesverbalet e kontrolleve të kryera nga inspektorët e peshkimit.

4. Struktura përgjegjëse ndjek në vijueshmëri përmbushjen dhe respektimin e detyrimeve dhe kushteve të kontratës, për këtë qëllim ajo mban dhe përditëson regjistrin e kontratave për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit dhe të akuakulturës bazuar, në:

- a) aktet e monitorimit dhe inspektimit;
- b) raportimet e subjektit;
- c) vendimmarrjet administrative të Ministrisë.

5. Për çdo kontratë të lidhur, Ministria i dorëzon një kopje edhe institucionit përgjegjës për inspektimin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës.

II. PROCEDURA E MONITORIMIT TË KONTRATAVE

1. Monitorimi i kontratave për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës bëhet në mënyrë periodike, sipas planit të miratuar, të paktën një herë në vit, nga struktura përgjegjëse.

2. Planet e monitorimit përgatiten nga struktura përgjegjëse dhe miratohen nga ministri.

3. Monitorimi mund të kryhet edhe pa planifikim, në rastet kur ka indicie apo dyshime për shkelje, të mbështetura në ankesa, informacione nga subjekte private, institucione shtetërore, apo nga verifikime në terren.

4. Monitorimi ka për objekt verifikimin e:

a) Realizimit të investimeve ndër vite dhe sipas zërave të deklaruar në kontratë dhe plan-biznesin e paraqitur nga subjektet në konkurrimin publik për të fituar të drejtën e ushtrimit të aktivitetit të peshkimit/akuakulturës, si dhe nga subjektet që kanë fituar të drejtën e ushtrimit të aktivitetit të akuakulturës në zonë tokësore private;

b) Respektimit të nivelit të punësimit;

c) Realizimit të sasisë së deklaruar të prodhimit dhe sasisë së zënieve;

ç) Zënieve/kultivimit sipas llojeve, sasisë dhe metodologjisë së përcaktuar në plan biznes;

d) Raportimit të deklarimeve statistikore dhe pagesës së detyrimeve financiare (taksa vjetore);

dh) Respektimit të sipërfaqes ujore/koordinatave të përcaktuara në kontratë;



e) Përdorimit të bazës materiale dhe mjeteve të deklaruar për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit/akuakulturës.

5. Procesi i monitorimit zhvillohet në këto faza:

5.1 Planifikimi dhe njoftimi:

a) Hartimi dhe miratimi i planit të monitorimit;

b) Njoftimi i subjektit të paktën 5 (pesë) ditë kalendarike përpara, duke përcaktuar dokumentacionin që duhet të paraqesë dhe afatin për dorëzimin e tij.

5.2 Monitorimi në terren:

a) Kontrolli i realizimit fizik të investimeve. Këto investime mund përfshijnë ndërtimet që shërbejnë për kultivimin e organizmave ujorë, të tillë si vaskat, kanalet furnizuese dhe shkarkuese, inkubatorët, laboratorët, magazinat frigoriferike, si dhe çdo ndërtim apo investim tjetër që shërben për ushtrimin e aktivitetit të akuakulturës, si dhe atë të peshkimit (varka, rrjeta peshkimi etj.), sipas treguesve të deklaruar në kontratë apo plan-biznes, pjesë integrale e kontratës;

b) Kontrolli i përputhshmërisë së sipërfaqes ujore dhe/ose koordinatave të përcaktuara në kontratë;

c) Verifikimi i përdorimit të bazës materiale dhe mjeteve të peshkimit, sipas parashikimeve të bëra në plan-biznes;

ç) Hartimi dhe mbajtja e procesverbalit të monitorimit, ku evidentohen gjetjet dhe konstatimet gjatë kontrollit në terren; procesverbali nënshkruhet nga palët përkatëse dhe subjekti kontraktor.

5.3 Shqyrtimi i dokumentacionit:

a) Analiza e dokumentacionit ekonomik/financiar dhe ligjor. Ky dokumentacion përfshin:

i. faturat tatimore (blerje), që vërtetojnë realizimin e investimeve sipas zërave dhe viteve të deklaruar në kontratë dhe plan-biznes;

ii. fatura tatimore (shitje) të produkteve peshkore që subjektet duhet të zejnë/kultivojnë sipas llojeve, sasisë dhe metodologjisë së përcaktuar në plan-biznes;

iii. leje ndërtimi, kontrata sipërmarrjeje, porosie ose dokumente të tjera ligjore që vërtetojnë ligjshmërinë e ndërtimeve apo investimeve të tjera të parashikuara në plan-biznes, të shoqëruara me fatura tatimore që provojnë pagesën e shërbimeve për realizimin e tyre. Ndërtimet apo investimet e tjera, të parashikuara në plan-biznes, duhet të jenë në funksion të ushtrimit të aktivitetit të akuakulturës/peshkimit, objekt kontrate.

b) Kontroll dhe verifikim i numrit të deklaruar të punonjësve përmes shqyrtimit të dokumentacionit përkatës (deklarata të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, vërtetime të pagesave të kontributeve, regjistri i punonjësve, listëpagesat mujore etj.);

c) Shqyrtim i raportimeve statistikore mbi të dhënat për zënie/kultivimin, për të verifikuar përputhshmërinë e të dhënave të raportuara me gjetjet faktike.

5.4 Analiza dhe raportimi:

a) Hartimi i raportit paraprak të monitorimit;

b) Evidentimi i shkeljeve (nëse ka) me referencë në dispozitat përkatëse ligjore dhe kontraktore.

5.5 E drejta për t'u dëgjuar:

a) Njoftimi i subjektit për gjetjet;

b) Dhënia e një afati prej 7 (shtatë) ditësh kalendarike për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare.

5.6 Vendimarrja administrative:

a) Shqyrtimi i pretendimeve përfundimtare;

b) Hartimi i raportit përfundimtar, i cili evidenton shkeljet e konstatuara, si dhe rekomandimet dhe propozimet për masat përkatëse, me referencë në dispozitat ligjore dhe kontraktore në fuqi; sipas rastit, raporti përfshin masa për përmirësim, duke përcaktuar afate të qarta dhe të arsyeshme për përmbushje, ose propozon zgjidhjen e kontratës kur shkeljet janë të natyrës që e justifikojnë këtë masë;

c) Miratimi i raportit nga ministri i shoqëruar, në rast se propozohet zgjidhja e kontratës, me urdhrin përkatës për zgjidhjen e saj;

ç) Njoftimi i subjektit për masën e marrë.

6. Shqyrtimi dhe analiza e dokumentacionit ekonomik/financiar dhe ligjor kryhet brenda një afati prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh kalendarike nga data e paraqitjes së dokumentacionit përkatës nga subjekti kontraktor. Në rastin e OMP-ve, shqyrtimi dhe analiza e dokumentacionit ekonomik/financiar dhe ligjor kryhet brenda një afati prej 30 ditësh kalendarike.

7. Raporti përfundimtar i monitorimit të çdo kontrate hartohet brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike nga data e përfundimit të afatit të caktuar në pikën 6 të këtij kreu.

8. Në raste të veçanta, për shkak të volumit të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, ose kur natyra dhe kompleksiteti i çështjeve të konstatuara kërkojnë kohë shtesë për analizë dhe verifikim, afatet e përcaktuara në pikat 6 dhe 7 të këtij kreu



mund të zgjaten për një periudhë shtesë, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.

9. Në kategoritë ujore të shpallura si zona bashkëmenaxhimi ku funksionojnë Organizatat e Menaxhimit të Peshkimit (OMP), struktura përgjegjëse dhe institucioni përgjegjës për inspektimin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës monitorojnë zbatimin e kushteve të kontratës që Ministria ka lidhur me OMP-në përkatëse dhe të planit të bashkëmenaxhimit. Procesi i monitorimit kryhet sipas pikës 5 të këtij kreu.

III. DISPOZITAT E FUNDIT

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet struktura përgjegjëse për monitorimin e kontratave të peshkimit dhe akuakulturës në ministri, si dhe institucioni përgjegjës për inspektimin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës.

2. Udhëzimi nr. 11, datë 10.9.2020, “Për procedurat e monitorimit të zbatimit të kontratave për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit në ujërat e brendshme dhe akuakulturën tokësore dhe bujqësore”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

1. Në pjesën A:

a) Pas rreshtit 299, shtohet rreshti 300 me përmbajtje si vijon:

Nr.	Emri zakonshëm, Numri i identifikimit	Emri IUPAC	Pastërtia	Data e miratimit	Skadimi i miratimit	Dispozita specifike
300	Prohexadione CAS No 127277-53-6 (prohexadione-calcium) CIPAC No 567 (pro hexadione) No 567.020 (prohex adione-calcium)	3,5-dioxo-4-propionylcyclohexanecarboxylic acid	≥ 890 g/kg (expressed as prohexadione-calcium)	1 janar 2012	15 maj 2028	Mund të autorizohen përdorimi vetëm si rregullator i rritjes së bimëve. Për zbatimin e parimeve uniforme duhet të merren në konsideratë përfundimet e raportit të rishikimit mbi prohexadione dhe, në veçanti, shtojcat I dhe II të tij, siç janë finalizuar në Komitetin e Përhershëm për Zinxhirin Ushqimor dhe Shëndetin e Kafshëve, më 17 qershor 2011.

URDHËR

Nr. 402, datë 15.4.2026

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 275, DATË 5.5.2023, “PËR MIRATIMIN E LËNDËVE VEPRUESE DHE PËRBËRËSVE TË TJERË, NË PËRMBAJTJE TË PMB-ve”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të nenit 19, pika 5, të kreut V, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar; si dhe të vendimit nr. 335, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për regjistrimin të procedurës dhe kritereve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

I. Në shtojcën 1, të urdhrit nr. 275, datë 5.5.2023, “Për miratimin e lëndëve vepruese dhe përbërësve të tjerë, në përmbajtje të PMB-ve”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë:



b) Rreshtat 15, 27, 31 dhe 260 zëvendësohen me përmbajtjen, si vijon:

Nr.	Emri zakonshëm, Numri i identifikimit	Emri IUPAC	Pastërtia	Data e miratimit	Skadimi i miratimit	Dispozita specifike
15	Milbemectin Milbemectin është një përzierje e M.A ₃ dhe M.A ₄ CAS No: M.A ₃ : 51596-10-2 M.A ₄ : 51596-11-3 CIPAC No: 660	M.A ₃ : (10E,14E,16E)- (1R,4S,5'S,6R,6'R,8R,13, 20R,21R,24S)- 21,24-dihydroxy-5',6',11,13,22- pentamethyl-(3,7,19- trioxatetracyclo[15.6.1.1 ^{4,8} ,0 ^{20,24}] pentacosa-10,14,16, 22-tetraene)-6- spiro-2'-(tetrahydropyran)-2-one; M.A ₄ : (10E,14E,16E)- (1R,4S,5'S,6R,6'R,8R,13R, 20R,21R,24S)-6'-ethyl-21,24- dihydroxy- 5',11,13,22-tetramethyl-(3,7,19- trioxatetracyclo[15.6.1.1 ^{4,8} ,0 ^{20,24}] pentacosa-10,14,16,22-tetraene)-6- spiro-2'-(tetrahydropyran)-2-one	≥ 950 g/kg	16 nëntor 2025	15 nëntor 2040	Për implementimin e parimeve uniformë, siç përmenden në urdhrin nr. 275, datë 5.5.2023, “Për miratimin e lëndëve vepruese dhe përbërësve të tjerë, në përmbajtje të PMB-ve”, duhet të merren parasysh përfundimet e raportit të rinovimit mbi milbemectinën dhe, në veçanti, shtojcat I dhe II të tij. Në këtë vlerësim të përgjithshëm, duhet t'u kushtohet vëmendje e veçantë: - specifikimit të materialit teknik siç prodhohet komercialisht; - mbrojtjes së operatorëve dhe punëtorëve, duke siguruar që kushtet e përdorimit të përfshijnë zbatimin e pajisjeve të përshtatshme mbrojtëse personale; - mbrojtjes së bletëve dhe pjalmuesve që mund të ekspozohen ndaj lëndës vepruese duke vizituar lulet e pranishme në kulturë në kohën e aplikimit; - mbrojtjes së organizmave ujorë. Kushtet e përdorimit duhet të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, veçanërisht për të zvogëluar shpërndarjen në zonat tokësore dhe ujore jashtë fushës së trajtuar, kur është e përshtatshme. Aplikanti duhet të paraqesë informacionin konfirmues, si më poshtë: 1. Për të konfirmuar që palca e kockave është ekspozuar në testin e mikronukleusit <i>in vivo</i> të disponueshëm, ose për të konfirmuar mungesën e potencialit aneugjenik të milbemectinës. 2. Një studim krahasues <i>in vitro</i> i metabolizmit me milbemectinë (të paktën në speciet kryesore të përdorura për të karakterizuar toksicitetin e milbemectinës dhe në krahasim me metabolizmin njerëzor); 3. Një studim fototoksiciteti <i>in vitro</i> me milbemectinë, duke testuar diapazonin e gjatësive të valëve (midis 290 dhe 700 nm), ku koeficienti i absorbimit është > 10 L x mol⁻¹ x cm⁻¹; 4. Një vlerësim i përditësuar i rrezikut për organizmat e sedimenteve ujorë, në përputhje me dokumentin udhëzues të EFSA-s mbi vlerësimin e rrezikut të



						shkallëzuar për produktet e mbrojtjes së bimëve për organizmat ujorë në ujërat sipërfaqësore në sipërfaqe të fushave. Për të lejuar krahasimin e duhur të ndjeshmërisë me specie të tjera, ky informacion konfirmues duhet të përfshijë një test të sedimentit të shtuar (OECD TG 218) dhe një test të ujit të shtuar (OECD TG 219) me Chironomidae të ekspozuara ndaj milbemektinës, ku milbemicina A3/milbemicina A4 është e pranishme në të njëjtin raport si në studimet e tjera ekotoksikologjike.
27	Pyrimethanil CAS No: 53112-28-0 CIPAC No: 714	N-(4,6- dimethylpyrimidin-2-yl) aniline	≥ 975 g/kg Papastërtitë e mëposhtme nuk duhet të tejkalojnë nivelet e mëposhtme në materialin teknik: - c yanamide: 0,5 g/kg; - aniline: 4 g/kg; - acetylacetone: 0,1 g/kg	1 Maj 2026	30 Prill 2041	Për implementimin e parimeve uniformë, siç përmendet në urdhrin nr. 275, datë 5.5.2023, “Për miratimin e lëndëve vepruese dhe përbërësve të tjerë, në përmbajtje të PMB-ve”, duhet të merren parasysht përfundimet e raportit të rinovimit për pyrimetanilin dhe, në veçanti, shtojcat I dhe II të tij. Në këtë vlerësim të përgjithshëm, duhet t’u kushtohet vëmendje e veçantë: - mbrojtjes së operatorëve, duke siguruar që kushtet e përdorimit të përfshijnë zbatimin e pajisjeve të përshtatshme mbrojtëse personale; - mbrojtja e kalimtarëve dhe banorëve, duke siguruar që të zbatohen masat për reduktimin e rrjedhjes së ujit, aty ku është e nevojshme; - mbrojtja e organizmave ujorë, bletëve dhe pjalmuesve të tjerë. Kushtet e përdorimit duhet të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, kur është e përshtatshme. Aplikanti duhet të paraqesë informacion konfirmues në lidhje me: 1. Toksicitetin e metabolitit M605F004, duke përfshirë konjugatet e tij, dhe metabolitit M605F007, për të konfirmuar përkufizimet përkatëse të mbetjeve për vlerësimin e rrezikut; 2. Efekti i proceseve të trajtimit të ujit në mbetjet e pyrimetanilit ose metabolitëve të tij të pranishëm në ujin e nxjerrë për prodhimin e ujit të pijshëm, në përputhje me dokumentin udhëzues të EFSA-s dhe ECHA-s mbi ndikimin e proceseve të trajtimit të ujit në mbetjet e substancave aktive, ose metabolitëve të tyre në ujin e nxjerrë për prodhimin e ujit të pijshëm;



						3. Degradimi i pyrimetanilit në tokë, duke përfshirë, aty ku është e nevojshme, identifikimin dhe karakterizimin e metabolitëve. Nëse informacioni tregon rëndësinë e metabolitit U2, duhet të sigurohet ekspozimi ndaj tokës, ujërave sipërfaqësore, sedimenteve dhe ujërave nëntokësore dhe vlerësimi i rrezikut për metabolitin U2.
31	Spinosad CAS No: 168316-95-8 Spinosyn A: 131929-60-7 Spinosyn D: 131929-63-0 CIPAC No: 636	Spinosyn A: (50–95 %) (2R,3aS,5aR,5bS,9S,13S,14-R,16aS,16bR)-2-(6-deoxy-2,3,4-tri-O-methyl-α-L-mannopyranosyloxy)- 13-(4-dimethylamino-2,3,4,6-tetradeoxy-β-D-erythropranosyloxy)- 9-ethyl-2,3,3a,5a,5-b,6,7,9,10,11,12,13,14,15,16a,16b-hexadecahydro-14-methyl-1H-as-indaceno[3,2-d] oxacyclododecine-7,15-dione Spinosyn D: (50–5 %) (2S,3aR,5aS,5bS,9S,13S,14R,16aS,16bS)-2-(6-deoxy-2,3,4-tri-O-methyl-α-L-mannopyranosyloxy)- 13-(4-dimethylamino-2,3,4,6-tetradeoxy-β-D-erythropranosyloxy)- 9-ethyl-2,3,3a,5a,5-b,6,7,9,10,11,12,13,14,15,16a,16b-hexadecahydro-4,14-dimethyl-1H-as-indaceno[3,2-d] oxacyclododecine-7,15-dione	≥ 850 g/kg with 50–95 % of spinosyn A and 5–50 % of spinosyn D ≥ 850 g/kg me 50–95% të spinosyn A dhe 5–50% të spinosyn D	1 prill 2026	1 prill 2041	Për implementimin e parimeve uniforme, siç përmendet në urdhrin nr. 275, datë 5.5.2023, “Për miratimin e lëndëve vepruese dhe përbërësve të tjerë, në përmbajtje të PMB-ve”, duhet të merren parasysht, përfundimet e raportit të rinovimit për spinosad të 11 dhjetorit 2025 dhe, në veçanti, shtojcat I dhe II të tij. Në këtë vlerësim të përgjithshëm, duhet t’u kushtohet vëmendje e veçantë: - vlerësimi të marrjes së ushqimit nga konsumatori, duke marrë parasysht mbetjet e metabolitëve të spinosadit dhe duke marrë parasysht impaktin e ruajtjes dhe përpunimit; - mbrojtja e operatorëve, veçanërisht për aplikimet me dorë në kulturat e ulëta; - mbrojtja e gjitarëve të egër, organizmave ujorë, bletëve dhe artropodëve jo të synuar. Kushtet e përdorimit duhet të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, kur është e përshtatshme. Aplikanti duhet të paraqesë informacion konfirmues, në lidhje me: 1. Një studim krahasues i metabolizmit ndërspeciesh <i>in vitro</i>; 2. Një vlerësim i përgjithshëm i TND-së (neurotoksicitetit zhvillimor), duke përfshirë dorëzimin e të dhënave nga një bateri testesh DNT <i>in vitro</i>; 3. Toksiciteti dhe niveli i mbetjeve në matricat bimore dhe shtazore të spinosinës B dhe K, PsA dhe MET A-Li-4(5b) për të konfirmuar përkufizimet e mbetjeve për vlerësimin e rrezikut; 4. Efekti i proceseve të trajtimit të ujit në natyrën e mbetjeve të pranishme në ujin e pijshëm; 5. Efekte kronike te bletët (në adultë dhe larva). Për implementimin e parimeve uniforme, siç përmendet në urdhrin nr. 275, datë 5.5.2023 “Për miratimin e lëndëve vepruese dhe përbërësve të tjerë, në përmbajtje të PMB-ve”, duhet të merren parasysht, përfundimet e raportit të



						rinovimit për spinosad të 11 dhjetorit 2025 dhe, në veçanti, shtojcat I dhe II të tij. Në këtë vlerësim të përgjithshëm, duhet t'u kushtohet vëmendje e veçantë: - vlerësimi të marrjes së ushqimit nga konsumatori, duke marrë parasysh mbetjet e metabolitëve të spinosadit dhe duke marrë parasysh impaktin e ruajtjes dhe përpunimit; - mbrojtja e operatorëve, veçanërisht për aplikimet me dorë në kulturat e ulëta; - mbrojtja e gjitarëve të egër, organizmave ujorë, bletëve dhe artropodëve jo të synuar. Kushtet e përdorimit duhet të përfshijnë masa për zbutjen e rrezikut, kur është e përshtatshme. Aplikanti duhet të paraqesë informacion konfirmues, në lidhje me: 1. Një studim krahasues i metabolizmit ndërspeciesh <i>in vitro</i>; 2. Një vlerësim i përgjithshëm i TND-së (neurotoksicitetit zhvillimor), duke përfshirë dorëzimin e të dhënave nga një bateri testesh DNT <i>in vitro</i>; 3. Toksiteti dhe niveli i mbetjeve në matricat bimore dhe shtazore të spinosinës B dhe K, PsA dhe MET A-Li-4(5b) për të konfirmuar përkufizimet e mbetjeve për vlerësimin e rrezikut; 4. Efekti i proceseve të trajtimit të ujit në natyrën e mbetjeve të pranishme në ujin e pijshëm; 5. Efekte kronike te bletët (në adultë dhe larva). Aplikanti duhet të paraqesë informacionin e përmendur në pikat 1, 3 dhe 4 deri më 11 mars 2028. Aplikanti duhet të paraqesë informacionin e përmendur në pikën 2 brenda dy vjetësh pas miratimit të një dokumenti udhëzues për vlerësimin e DNT-së. Aplikanti duhet të paraqesë informacionin e përmendur në pikën 5 brenda dy vjetësh pas miratimit të një dokumenti udhëzues me një metodologji të rishikuar të vlerësimit të rrezikut për bletët e mjaltit.
260	Maleic hydrazide CAS No 123-33-1 CIPAC No 310	6-hydroxy-2H-pyridazin-3-one	≥ 979 g/kg Papastërtia hidrazinë nuk duhet të tejkalojë 0,028 mg/kg në materialin teknik.	1 nëntor 2017	31 tetor 2032	Për implementimin e parimeve uniforme, siç përmendet në urdhrin nr. 275, datë 5.5.2023 “Për miratimin e lëndëve vepruese dhe përbërësve të tjerë, në përmblajtje të PMB-ve”, duhet të merren parasysh përfundimet e raportit të rinovimit për hidrazidin malik dhe, veçanërisht, shtojcat I dhe II të tij, si dhe shtesat e tij.



						Në këtë vlerësim të përgjithshëm, duhet t'u kushtohet vëmendje e veçantë: - mbrojtjes së konsumatorëve; sigurisë së operatorëve dhe punëtorëve; kushtet e përdorimit duhet të përfshijnë përdorimin e pajisjeve të përshtatshme mbrojtëse personale. - Kushtet e përdorimit duhet të përfshijnë masat për zvogëlimin e rrezikut, kur është e përshtatshme.
--	--	--	--	--	--	--

c) Përmbajtja e rreshtave 82, 83, 86, 187 fshihet.

ç) Në pjesën A në kolonën 6, “Skadimi i miratimit”, bëhen ndryshimet e afateve si vijon:

1. Në rreshtin 27, Pyrimethanil, data zëvendësohet me “30 qershor 2027”;
2. Në rreshtin 28, Triclopyr, data zëvendësohet me “31 mars 2027”;
3. Në rreshtin 45, Boscalid, data zëvendësohet me “31 mars 2028”;
4. Në rreshtin 52, Difenconazole, data zëvendësohet me “31 janar 2028”;
5. Në rreshtin 56, Diflufenican, data zëvendësohet me “31 gusht 2027”;
6. Në rreshtin 60, Flutolanil, data zëvendësohet me “15 qershor 2027”;
7. Në rreshtin 61, Fluazinam, data zëvendësohet me “30 nëntor 2027”;
8. Në rreshtin 72, Fenpyroximate, data zëvendësohet me “31 janar 2028”;
9. Në rreshtin 77, Aluminium silicate, data zëvendësohet me “31 mars 2027”;
10. Në rreshtin 80, Extract from tea tree/vaji i pemës së çajit, data zëvendësohet me “15 dhjetor 2027”;
11. Në rreshtin 85, Plant oils/clove oil/vajra bimore/vaj karafili, data zëvendësohet me “30 qershor 2028”;
12. Në rreshtin 87, Plant oils/spear mint oil/vajra bimore/vaj menteje, data zëvendësohet me “15 janar 2028”;
13. Në rreshtin 88, Pyrethrinat, data zëvendësohet me “30 prill 2028”;
14. Në rreshtin 113, Sulphur, data zëvendësohet me “31 korrik 2027”;
15. Në rreshtin 120, Malathion, data zëvendësohet me “15 korrik 2028”;
16. Në rreshtin 121, Penoxsulam, data zëvendësohet me “15 maj 2027”;
17. Në rreshtin 122, Proquinazid, data zëvendësohet me “31 dhjetor 2027”;
18. Në rreshtin 128, Pyridaben, data zëvendësohet me “31 janar 2030”;
19. Në rreshtin 131, 6-benziladeninë, data zëvendësohet me “15 janar 2030”.
20. Në rreshtin 135, Dodine, data zëvendësohet me “30 qershor 2028”;
21. Në rreshtin 136, Indolylbutyric acid, data zëvendësohet me “31 janar 2028”;
22. Në rreshtin 140, 1-decanol, data zëvendësohet me “30 qershor 2028”;
23. Në rreshtin 142, Fluometuron, data zëvendësohet me “15 janar 2030”;
24. Në rreshtin 145, Sintofen, data zëvendësohet me “15 janar 2030”;
25. Në rreshtin 150, Aluminium sulfate, data zëvendësohet me “15 janar 2030”;
26. Në rreshtin 155, Flurochloridone, data zëvendësohet me “31 tetor 2027”;
27. Në rreshtin 158, Spiroxamine, data zëvendësohet me “30 nëntor 2029”;
28. Në rreshtin 163, 1-naphthylacetamide, data zëvendësohet me “30 nëntor 2029”;
29. Në rreshtin 164, 1-naphthylacetic acid, data zëvendësohet me “30 nëntor 2029”;
30. Në rreshtin 165, Fluazifop-P, data zëvendësohet me “30 nëntor 2029”;
31. Në rreshtin 171, Phosphane, data zëvendësohet me “15 mars 2027”;
32. Në rreshtin 183, Potassium phosphonates, data zëvendësohet me “31 korrik 2029”;
33. Në rreshtin 187, Maltodextrin, data zëvendësohet me “28 shkurt 2027”;
34. Në rreshtin 188, Eugenol, data zëvendësohet me “15 prill 2028”;



35. Në rreshtin 189, Geraniol, data zëvendësohet me “15 prill 2028”;
 36. Në rreshtin 190, Thymol, data zëvendësohet me “15 prill 2028”;
 37. Në rreshtin 194, Fluopyram, data zëvendësohet me “15 qershor 2028”;
 38. Në rreshtin 197, Disodium phosphonate, data zëvendësohet me “31 korrik 2029”;
 39. Në rreshtin 200, Penthiopyrad, data zëvendësohet me “31 tetor 2025”;
 40. Në rreshtin 240, Pinoxaden, data zëvendësohet me “31 dhjetor 2029”.

2. Në pjesën C, shtohen rreshtat 54, 55, 56, 57 me përmbajtjen si vijon:

Nr.	Emri zakonshëm Numri i identifikimit	Emri IUPAC	Pastërtia	Data e miratimit	Skadimi i miratimit	Dispozita specifike
